



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II nr.927/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit NHT Dardania 9000 nga fshati Dardani në Ferizaj të cilin me autorizim e përfaqëson Nezir Bytyqi avokat në Ferizaj, kundër debitorit EB Residence shpk nga Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson Fitim Shabani avokat nga Ferizaj, me bazë përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.652/23 datës 12.02.2024, me datë 13.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit EB Residence shpk nga Ferizaj, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.652/23 i datës 12.02.06.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr652/23 dt.12.02.2024, ka hedhur poshtë si të pasafatshëm prapësimin e debitorit EB Residence shpk nga Ferizaj, i ushtruar kundër urdhrin përmbartimor P.nr.179/23 dt.29.03.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Besnik Aliu, .

Kundër këtij aktvendimi, ka ushtruar ankesë i autorizuari i debitorit, për shkak se gjykata gabimisht ka vendosur kur e ka hedhur poshtë si të pas afatshëm prapësimin e debitorit m faktin se urdhrin përmbartimor dt.29.03.2023 e ka pranuar me datën 05.04.2023 e vërtetuar me flete dërgesën për dorëzim personal, ndërsa prapësimi është dorëzuar me datën 13.04.2023 e që afati i fundit ka qenë data 12.04.2023, konsiderojmë se është bërë gabim i gjendjes faktike sepse urdhri përmbartimor është pranuar pa autorizim nga pala debitorë prandaj i propozon gjykatës së shkallës se dytë, që këtë ankesë ta aprovoj si te bazuar, ndërsa aktvendimin e atakuar ta anuloj dhe çështja te kthehet ne shkallë te parë ne rivendosje.

Në përgjigje në ankesë, i autorizuari i kreditorit deklaroi se gjykata e shkallës së parë me te drejt e ka hudh poshtë prapësimin e debitorit nga neni 70 i LPP-së, të paraqitur pas afatit ligjor, andaj i propozon gjykatës së shkallës së dytë që të refuzohet si e pabazuar ankesa e debitorit dhe te mbetet ne fuqi aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.652/23 i datës 12.02.06.2024

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), pas vlerësimit të ankesës dhe komplet shkresave të lëndës, ka gjetur se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori NHT Dardania 9000 nga fshati Dardani në Ferizaj të cilin me autorizim e përfaqëson Nezir Bytyqi avokat në Ferizaj, me datën 29.03.2023, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit EB Residence shpk nga Ferizaj, në bazë të dokumentit të besueshëm Faturave nr.019601 dt.28.02.2022, 019602/01.03.2022, 019603 dt.01.03.2022, 019604 dt.02.04.2022, 019608 dt.30.04.2022, 019609 dt.30.04.2022, 019610 dt.01.06.2022, 019611 dt.01.06.2022 në shumë të përgjithshme prej 7,618.00€.

Përmbarruesi Privat Besnik Aliu, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim, me urdhrin përmbarrimor P.nr.179/2023 dt.29.03.2023, ka lejuar përmbarrimin me të cilin ka obliguar debitorin që kreditorit në emër të borxhit nga faturat të paguaj shumën prej 7,618.00 euro, me kamatë prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës.

Ndaj urdhrin përmbarrimor i autorizuar i debitorit ka ushtruar prapësim, me datën 13.04.2023.

Kreditori përmes të autorizuarit ka paraqitur përgjigjen në prapësim me datën 18.04.2023

Dhoma e shkallës së parë, pas shqyrtimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim si edhe shkresave në lëndë, ka nxjerr aktvendimin KPPP nr.652/23 dt.12.02.2024, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit. Në arsyetim të aktvendimit gjykata vlerëson se debitori me datën 05.04.2023 e ka pranuar urdhrin përmbarrimor P.nr.179/23 dt.29.03.2023 që vërtetohet nga fletë dërgesa për dorëzim personal, ndërsa prapësimin e ka dorëzuar me datën 13.04.2023 që vërtetohet nga vula e pranimit të përmbarruesit privat. Gjykata në këtë rast i referohet nenit 70 të LPP, dhe nenit 126 par.2 të LPK andaj bazuar në faktin se afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar nga data 06.04.2023 rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 12.04.2023. Andaj bazuar në këto arsye dhe konform neni 73 par.3 të LPP ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 e as neni 183 të LPK, e të cilat shkaqë ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore përcaktohet së: *“Prapësimi duhet të dorëzohet gjykatës brenda shtatë (7) ditësh pas pranimit të vendimit përmbarrues ose urdhrin përmbarrues”*, ndërsa me dispozitën e nenit 73 paragrafi 3, parashihet së: *“Me vendim*

*prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar”.*

Në këtë kontekst dhe në kuptim të kësaj dispozite, Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe ligjërisht ka vendosur kur e ka hedhur si të pasafatshëm prapësimin e debitorit, sepse nga provat në shkresat e lëndës konstatohet se debitori Urdhri Përmbartimor P.nr.179/23 dt.29.03.2023 e ka pranuar me datë 05.04.2023, gjë që vërtetohet përmes fletë kthesës për dorëzim personal, ndërsa prapësimin e ka dorëzuar tek Përmbartuesi Privat me datën 13.04.2022 gjë që vërtetohet përmes vulës së përmbartuesit privat. Andaj marrë për bazë faktin se debitori urdhri për përmbartim e ka pranuar me datën 05.04.2023 del se afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar nga data 06.04.2023 dhe se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 12.04.2023, nga kjo rezulton se debitori nuk ka vepruar brenda afatit ligjor prej 7 ditësh për paraqitjen e prapësimit.

Kjo gjykatë i ka analizuar pretendimet ankimore të debitorit, por të njëjtat i ka vlerësuar si të pabazuara dhe të paargumentuara me prova konkrete, prandaj të njëjtat i refuzoi ndërsa aktvendimin e atakuar e vërtetoi. Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se urdhri përmbartimor është dërguar tek përsosni i pa autorizuar, ngase fletë dërgesa për dorëzim personal e datës 05.04.2023 është në emër të debitorit.

Kompetenca e Dhomës së shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) e LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.927/24 me datë 13.06.2024

Gjyqtari  
Krenar Berisha